

EDUART ÇAKA

---

**VAKËFET**  
**dhe ndikimi i tyre social**  
**në Shqipërinë e periudhës osmane**



AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
INSTITUTI I HISTORISË



**EDUART CAKA**

**V A K Ë F E T**  
**DHE NDIKIMI I TYRE SOCIAL**  
**NË SHQIPËRINË E PERIUDHËS OSMANE**

Tiranë, 2021

*Miratuar për botim nga:*

Departamenti i Historisë së Mesjetës, Periudhës Osmane  
dhe Rilindjes pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike

*Recensentë:*

**Prof. asoc. dr. Edmond Malaj**

**Prof. dr. Abdülhamit Kırmızı**

*Redaktore gjuhësore:* Meliha BALLA

*Përkujdesja grafike:* Mirela MIHALI

*Kopertina:* Dorina MUKA

ISBN 978-9928-289-73-5

© Autori & Akademia e Studimeve Albanologjike / Instituti i Historisë

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Shtëpia botuese:

## Pasqyra e lëndës

<i>Parathënie</i> .....	9
<i>Hyrje</i> .....	13
a. Burimet .....	15
b. Metodologjia .....	22

### PJESA I VAKËFI

<b>KAPITULLI I</b>	
<b>INSTITUCIONI I VAKËFIT</b> .....	<b>27</b>
Institucioni i Vakëfit dhe diskutimet mbi origjinën e tij .....	27
<i>Mendimi i buazimit të vakëfit nga Roma dhe Bizanti</i> .....	30
<i>Vakëfet në traditën e vjetër turke</i> .....	35
<i>Vakëfi në Mesopotami</i> .....	36
Institucioni i vakëfit në Perandorinë Osmane.....	41
Evkaf-ı Hümayun Nezareti dhe institucioni.....	56
i vakëfit në shek. XIX .....	56

<b>KAPITULLI II</b>	
<b>VAKËFI DHE ELEMENTËT PËRBËRËS TË TIJ</b> .....	<b>63</b>
Përkufizimi dhe statusi juridik i Vakëfit .....	64
Elementët përbërës të Vakëfit .....	69
<i>Vaksfja</i> .....	70
<i>Vakëflënësi</i> .....	75
<i>Administrimi</i> .....	78
Kategoritë e vakëfeve.....	87
<i>Vakëfet Hajri</i> .....	88
<i>Vakëfet Zurri</i> .....	88

<i>Vakëfjet Avariz</i> .....	93
<i>Lloje të tjera vakëfesh</i> .....	96
Vakëfjet monetare .....	98
Çështjet gjyqësore të vakëfeve.....	106

## PJESA II VAKËFET NË SHQIPËRI GJATË SHEK. XVI-XIX

### KAPITULLI I

<b>VAKËFET NË SHQIPËRI .....</b>	<b>115</b>
Mbi vakëfjet më të hershme në Shqipëri.....	120
Periodha e lulëzimit të vakëfeve.....	125
Institucioni i vakëfit në Shqipëri gjatë shek. XIX.....	130
Vakëfjet dhe fisnikëria shqiptare .....	133

### KAPITULLI II

<b>VAKËFE TË MËDHA .....</b>	<b>147</b>
Vakëfi i Iljaz Bej Mirahorit.....	148
Vakëfe të mëdha të Beratit.....	166
<i>Vakëfi i Ahmet Bej Uzgurit</i> .....	167
<i>Velabishtët dhe veprat e tyre të bamirësisë</i> .....	172
Vakëfe të mëdha të Shkodrës .....	176
<i>Vakëfi i Ali Beut</i> .....	177
<i>Vakëfjet e Bushatllinjve</i> .....	181
Vakëfjet e Biçakçinjve.....	185
Ali Pashë Tepelena dhe veprat e tij të bamirësisë.....	188
Vakëfe të pashallarëve dhe vezirëve të mëdhenj me origjinë shqiptare.....	192
<i>Mehmet Pashë Kopryliu dhe veprat e tij të bamirësisë në Roshnik</i> .....	193
<i>Vakëfjet e Ajaq Pashës</i> .....	196
<i>Koxha Sinan Pasha nga fshati Topoan, i cili njihet ndryshe edhe si marrësi i Jemenit</i> .....	200
<i>Hadim Hafiz Ahmed Pasha dhe vakëfjet e tij në Elbasan</i> .....	203
<i>Vakëfjet e Dukagjinëve</i> .....	205
<i>Vakëfi i Sinanuddin Jusuf Pashës në Elbasan</i> .....	208
<i>Abdurrahman Abdi Pasha dhe veprat e tij të bamirësisë në Peqin</i> .....	211
Vakëfe të komandantëve e ushtarakëve .....	214

PJESA III  
ROLI DHE FUNKSIONI SHOQËROR  
I VAKËFEVE NË SHQIPËRINË OSMANE

**KAPITULLI I**

**VAKËFET DHE EKONOMIA..... 221**

Vështrim i përgjithshëm mbi ekonominë në Shqipëri nga fillimet e shek. XVII deri në gjysmën e parë të shek. XIX.....	221
Vakëfet dhe zhvillimi urban.....	245
<i>Vakëfet dhe arkitektura urbane</i> .....	266
<i>Vakëvet dhe transporti: banet, urat e rrugët</i> .....	271
Vakëfet dhe esnafet.....	285
Esnafi i tabakëve.....	298
Vakëfet dhe punësimi.....	301

**KAPITULLI II**

**VAKËFET DHE OBJEKTET E KULTIT ..... 307**

Xhamitë.....	309
<i>Berati</i> .....	312
<i>Dibra</i> .....	318
<i>Durrësi</i> .....	321
<i>Elbasani</i> .....	325
<i>Gjirokastra</i> .....	329
<i>Korça</i> .....	336
<i>Shkodra</i> .....	338
<i>Tirana</i> .....	343
<i>Vlora</i> .....	350
Bektashizmi.....	353
Vakëfet dhe tarikatat.....	360

**KAPITULLI III**

**VAKËFET E JOMYSLIMANËVE..... 375**

Sistemi i Mileteve dhe përbërja shoqërore e Perandorisë Osmane.....	375
Veçori të Vakëfeve të Mileteve.....	385
Vakëfet e krishtera në qytetet shqiptare.....	389
<i>Berati</i> .....	391

<i>Durrësi</i> .....	395
<i>Elbasani</i> .....	397
<i>Gjirokastra</i> .....	398
<i>Korça</i> .....	400
<i>Voskopoja</i> .....	404
Mbi praninë e hebrenjve në Shqipëri gjatë periudhës së sundimit osman .....	407
Komuniteti katolik në kuadër të sistemit të mileteve.....	414

#### **KAPITULLI IV**

<b>VAKËFET DHE ROLI I TYRE SHOQËROR</b> .....	<b>423</b>
Vakëfet dhe arsimi.....	426
<i>Medresetë</i> .....	435
Vakëfet dhe shëndetësia .....	449
Vakëfet dhe kultura .....	459
Vakëfet dhe bibliotekat.....	463
Gratë dhe vakëfet .....	469
<i>Gratë si bamirëse</i> .....	476
<i>Gratë si administratore vakëfesh</i> .....	480
Vakëfet dhe skllavëria .....	481
<b>Burimet dhe bibliografia</b> .....	<b>489</b>
<b>Treguesi i emrave</b> .....	<b>509</b>



## Parathënie

Periodha e sundimit osman përfshin një hark kohor me rëndësi në historinë e shqiptarëve. Ndonëse ajo është e mirëdokumentuar, botimet e saj profesionale kanë qenë relativisht të pakta, ku veçojmë disa vëllime dokumentare të përgatitura prej studiuesve të fushës si dhe një numër të kufizuar monografish e përmbledhje studimesh. Arsyet e kësaj gjendjeje janë të shumta. Ato lidhen sa me mënyrën e funksionimit të kërkimit shkencor para viteve 90, po aq edhe me mungesën e studiuesve të fushës dhe të një strategjie të qartë kërkimore mbi studimet e kësaj periudhe. Në këtë drejtim nuk duhet lënë pa përmendur edhe vëmendja e paktë që vetë shteti shqiptar i ka kushtuar kërkimit shkencor në fushat albanologjike.

Ky konstatim del në pah qartësisht nëse do të bëjmë një krahasim të studimeve osmane në Shqipëri me ato të vendeve fqinjë. Kështu në vitet 60 të shekullit të kaluar, në vende të ndryshme të Ballkanit, siç janë Rumania, Bullgaria, Serbia e Bosnja, u përkthyen regjistrat kadastrorë osmanë të shek. XV, të cilat janë edhe burimet kryesore osmane për periudhën e hershme të historisë së kësaj perandorie. Ndërkohë që në vende të ndryshme të Ballkanit këto burime u botuan duke formuar bazën mbi të cilën do të përvijoheshin më tej studimet e karakterit ekonomik, shoqëror, demografik e politik, në Shqipëri nuk ndodhi kështu. Këto regjistra do të qëndronin gjatë në arkiva për ta parë dritën e botimit vetëm në vitet e fundit, çka në mendimin tonë ka ndikuar edhe në mbarëvajtjen e studimeve osmane.

Një fushë tjetër me të cilën u morën historianët ballkanas të periudhës osmane gjatë shekullit të kaluar, ishte edhe studimi i vakëfeve, institucione të cilat patën një rol thelbësor në zgjerimin e osmanëve si dhe në transformimin shoqëror të perandorisë. Ndërkohë që për historiografinë shqiptare, përveç dy artikujve të Petraq Pepos, kjo ka qenë një temë e patrajtuar.

Pikërisht këtu e merr shtysën edhe ky studim, i cili tenton të krijojë një panoramë të shtrirjes së vakëfeve në Shqipëri gjatë periudhës së sundimit osman, rolin e luajtur prej tyre në vendosjen e osmanëve në këtë gjeografi si dhe impaktin që këto institucione patën në transformimet politike, ekonomike, shoqërore e kulturore që pësoi kjo hapësirë gjatë shekujve osmanë. Parë nga ky këndvështrim, ky studim përpiket të realizojë një histori sociale të shqiptarëve për një periudhë tre shekullore, duke u përpjekur të mbushë një zbrazëti në studimet e deritanishme të kryera në Shqipëri mbi këtë periudhë dhe me këtë tematikë.

Në aspektin strukturor libri është ndarë në tri pjesë, të cilat kanë në përbërjen e tyre tetë kapituj. Në pjesën e parë, e cila konsiston në trajtimin teorik të temës, është analizuar institucioni i vakëfit, elementët kryesorë përbërës të tij si dhe aspekte që kanë të bëjnë me anët juridike e historike të fondacioneve të bamirësisë duke dhënë informacione rreth literaturës dhe terminologjisë mbi këtë fushë. Pjesa e dytë e librit ndalet në praninë e institucioneve të vakëfeve në Shqipëri duke u përpjekur të evidentojë ato më të hershmet të themeluara aty, si dhe jep një panoramë të zhvillimit të këtyre institucioneve përgjatë shekujve. Vend i veçantë i është kushtuar atyre që cilësohen si vakëfe të mëdha, institucione bamirësie që u ngritën prej vezirëve a pashallarëve në qytete e fshatra të ndryshme të Shqipërisë përmes ndërtimit të objekteve arkitekturore, të cilat i vinin në ndihmë komunitetit. Në pjesën e tretë, e cila përbën edhe thelbin e studimit tonë, jemi përpjekur të paraqesim impaktin social që vakëfet patën në hapësirën shqiptare si dhe rolin e këtyre institucioneve në komponentë të ndryshëm të jetës urbane e shoqërore ku spikasin arkitektura, arsimi, kultura e shëndetësia.

Boshti kryesor i studimit është formuar përmes hulumtimeve të realizuara pranë Arkivit Qendror Shtetëror të Republikës së Shqipërisë, Arkivit të Institutit të Historisë, Arkivit Osman pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave në Stamboll si dhe Arkivit të Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve në Ankara të Turqisë. Këtu dua të falënderoj të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e këtyre institucioneve, të cilët me profesionalizmin dhe dashamirësinë e treguar ma kanë lehtësuar punën kërkimore. Një falënderim i ndjerë shkon edhe për personelin e Bibliotekës Kombëtare dhe asaj të Akademisë së Studimeve Albanologjike. Gjithashtu dëshiroj të falënderoj drejtuesit e Qendrës së Studimeve

Islame (ISAM) në Stamboll, të cilët më ofruan një bursë studimi dymujore, duke më krijuar mundësinë për të hulumtuar në bibliotekën dhe fondet e tyre të pasura arkivore.

Libri është përmirësuar prej sugjerimeve e këshillave të vyera të kolegëve të Departamentit të Mesjetës dhe Rilindjes Kombëtare, dy recensentëve, Edmond Malaj dhe Abdülhamit Kırmızı, të anëtarëve të Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë, leximit tejet korrekt e dobiprurës të Ledia Dushkut, redaktimit gjuhësor të Meliha Ballës dhe përgatitjes teknike të Mirela Mihalit. U jam mirënjohës për kontributin e dhënë.

EDUART ÇAKA  
Dhjetor, 2021